



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 281/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitura ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohen** te pabazuar ankesat: Anr.281/2019, Anr. 282/2019, Anr.283/2019, Anr.284/2019, Anr.285/2019, Anr.286/2019, 288/2019, Anr. 289/2019, Anr.290/2019, Anr.291/2019, Anr. 301/2019, Anr.305/2019, Anr.306/2019, Anr.307/2019, Anr.308/2019, te gjitha te datës 05.10.2019, te paraqitura nga subjekti politik Lidhja Demokratike (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.281/2019, Anr. 282/2019, Anr.283/2019, Anr.284/2019, Anr.285/2019, Anr.286/2019, 288/2019, Anr. 289/2019, Anr.290/2019, Anr.291/2019, Anr. 301/2019, Anr.305/2019, Anr.306/2019, Anr.307/2019, Anr.308/2019, te gjitha te datës 05.10.2019, nga subjekti politik LDK, të gjitha të paraqitura kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilat kanë pretenduar, se me datë 05.10.2017, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidatët për deputet te paraqitur në ankesat e lartcekura, kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesat të pranohen si të bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesat janë të pabazuar**, për këto arsye:

Paneli paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.281/2019, Anr. 282/2019, Anr.283/2019, Anr.284/2019, Anr.285/2019, Anr.286/2019, 288/2019, Anr. 289/2019, Anr.290/2019, Anr.291/2019, Anr. 301/2019, Anr.305/2019, Anr.306/2019, Anr.307/2019, Anr.308/2019,

te gjitha te datës 05.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, të njëjtat janë paraqitur nga i njëjti subjekt politik dhe poashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, prandaj paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marres mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”,* andaj paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim te nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për te provuar se shkelësit e supozuar e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 05.10.2019.

Nga provat e ofruar nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave te shkelësve të supozuar që pretendohet, se janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.281/2019 më datën 06.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
Faton Ademi

*Faton Ademi*



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*